



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Në bazë të nenit 47, paragrafi 1, pika 6 të Ligjit për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15 dhe 16/06), neni 27-gj paragrafi 4 dhe neni 46 paragrafi 2 të Ligji për Qarkullim

Pagesor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 113/07, 22/08, 159/08, 133/09, 145/10, 35/11, 11/12, 59 / 12, 166/12, 170/13, 153/15 dhe 199/15), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë solli

V E N D I M

për dorëzimin e të dhënave për aktivitetet e kryera në qarkullimin pagesor

("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 42/16)

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

1. Me këtë vendim përcaktohet detyrimin për të dorëzuar të dhënat për aktivitetet e kryera në qarkullimin pagesor, përmbajtjen, mënyrën dhe afatet për dorëzimin e të dhënave në Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejshëm: Banka Popullore).

2. Njësitë raportuese për dorëzimin e të dhënave për aktivitetet e kryera në qarkullimin pagesor (në tekstin e mëtejshëm: raportues) janë:

- bankat, emetuesit e parave elektronike, personat juridikë të përfshirë në sistemin e pagesave ose kryejnë shërbime tjera lidhur me pagesat, ndërmjetësuesit e mikropagesave dhe ofrues të tjer të shërbimeve të pagesave (në tekstin e mëtejshëm: ofrues të shërbimeve të pagesave), dhe

- operatorët e sistemeve të pagesave.

II. LLOJET E TË DHËNAVE

3. Raportuesit duhet të dorëzojnë të dhëna për:

- llogaritë për kryerjen e pagesave;

- kartela pagese;

- pajisjet që pranojnë kartela pagese;

- transaksionet e pagesave sipas llojit të instrumentit të pagesës;

- transaksionet e pagesave sipas llojit të pajisjes;

- llojet e pjesëmarrësve në sistemin e pagesave, dhe

- pagesat e përpunuara përmes sistemeve të pagesave.

Raportuesit janë të detyruar të dorëzojnë të dhënat nga alinea 3, 4 dhe 5 të kësaj pike në aspektin e shtetit individual të cilat ato i referohen.

4. Raportuesit janë të detyruar të dorëzojnë të dhëna edhe për:

- numri i përgjithshëm i tregtarëve dhe numri i përgjithshëm i pikave të shitjes së tregtarëve në vend që janë klientë të ofruesit të shërbimit të pagesave dhe pranojnë kartelat e tij;

- tarifatat në pikën e shitjes që paguhen nga tregtarët, dhe

- tarifatat të cilat paguhen nga mbajtësi i kartelës së pagesës.

III. METODAT DHE AFATET E DORZIMIT TË TË DHËNAVE

5. Raportuesit janë të detyruar të dorëzojnë në baza mujore të dhënat nga pika 3 e këtij vendimi në mënyrë elektronike, nëpërmjet sistemit elektronik të Bankës Popullore për statistikën e pagesave, më së voni deri në ditën e pesëmbëdhjetë të muajit aktual, për muajin paraprak.

6. Raportuesit janë të detyruar të dorëzojnë në baza vjetore të dhënat nga pika 4 e këtij vendimi në mënyrë elektronike, përmes sistemit elektronik të Bankës Popullore për statistikën e pagesave, më së voni deri në ditën e pesëmbëdhjetë të muajit janar, për vitin e kaluar.

7. Të dhënat e dorëzuara që u përkasin dorzuesve individualë janë me karakter të fshehtë.

IV. SHPALLJA E TË DHËNAVE

8. Banka Popullore i publikon të dhënat në bazë mujore, ose në bazë vjetore në një formë të përmbledhur në faqen e internetit të saj, me përjashtim të të dhënave nga pika 4, alineat 2 dhe 3, të cilat do të përdoren vetëm për qëllime analitike të Bankës Popullore dhe nuk do të i nënshtrohen publikimit.

V. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

9. Guvernatori i Bankës Popullore me anë të udhëzimit përcakton llojin, përshkrimin dhe mënyrën e dorëzimit të raporteve me të dhëna nga pikat 3 dhe 4 të këtij vendimi.

Udhëzimi nga paragrafi 1 i këtij neni do të miratohet jo më vonë se një muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Raportuesit, sipas këtij vendimi, dorëzojnë të dhëna mujore nga periudha e raportimit e cila fillon në janar 2016 dhe të dhëna vjetore nga periudha e raportimit që fillon në vitin 2015. Të dhënat mujore për janar, shkurt dhe mars për vitin 2016 dhe të dhënat vjetore për vitin 2015 do të dorëzohen jo më vonë se 30 prill 2016.

10. Nga data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, pushon së qeni në fuqi Vendimi për dorëzimin e të dhënave për aktivitetet e kryera në qarkullimin pagesor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 146/07 dhe 50/13).

11. Ky Vendim hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", dhe do të zbatohet nga 1 prilli 2016.

V Nr.02-15 / II-3/2016

25 shkurt 2016

Shkup

**Guvernatori dhe Kryetar Këshilli i Bankës
Popullore të Republikës së Maqedonisë
Dimitar Bogov**